

· H · E · R ·
· I · T ·
· A · G · E ·
· S · P · A · C · E ·

Udhëzuesi
për Procesin
e Aplikimit

Udhëzuesi për Procesin e Aplikimit

Qëllimet afatgjata të platformës Heritage Space janë:

- Kontraktimi dhe mbështetja e realizimit të punimeve të reja;
- Ndërlidhja e trashëgimisë kulturore me artin dhe praktikat tjera kulturore;
- Shqyrtimi i mënyrave të reja dhe kreative për ruajtjen, promovimin dhe rijetësimin e trashëgimisë kulturore;
- Fuqizimin e rrjetit midis sektorëve dhe disiplinave të ndryshme kulturore;
- Vetëdijësimi i qytetarëve mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore si burim për zhvillimin kulturor, social dhe ekonomik;
- Punësimi i të rinjve në sektorin e kulturës.

Cilat ide do të mbështeten nga Heritage Space V?

Rrëfim dhe interpretim

Të vendosura së bashku, rrëfimi dhe interpretimi luajnë një rol të rëndësishëm në ndryshimin e mënyrës së qasjes, përvojës dhe komunikimit të trashëgimisë kulturore. Përkundër detajeve faktike, rrëfimi dhe interpretimi fokusohen në njerëz, në të kaluarën dhe lidhjen me vendin, dhe si të tilla, shpalosin tregimet njerëzore që qëndrojnë pas trashëgimisë së përbashkët.

Rrëfimi dhe interpretimi mund të përfshijnë: histori individuale dhe kombëtare të ruajtura dhe rrëfyera si tregime, narrativa të bazuara në fakte mirë të hulumtuara, dije lokale dhe thashetheme, përralla, mite, legjenda, fjalë-goje, që në përgjithësi, përmes medimeve të ndryshme shpalosin perspektiva që kanë për qëllim të argëtojnë, edukojnë, ruajnë dhe pasurojnë kulturën tonë të përbashkët.

Digjitalizimi i trashëgimisë

Me një shkallë në rritje të depërtimit të internetit në mbarë botën prej 59%, dhe me një normë vendore prej mbi 95%, digjitalizimi ka marrë një rol kyç në dhënie të mundësive për qasje në informacion. Për më tepër, përgjatë pandemisë aktuale globale, rënja drastike e mundësive për qasje në burime kulturore (mbi 90% e muzeve në të gjithë botën janë mbyllur përkohësisht), ka prodhuar një nevojë të theksuar për proceset siç janë digjitalizimi dhe ruajtja digjitale.

Digjitalizimi dhe qasja online ofrojnë komunikim dhe promovim më të madh të koleksioneve të ndryshme të muzeve, librarive dhe arkivave. Krahas tërheqjes së vizitorëve, turistëve dhe hulumtuesve, kjo gjithashtu tërheq edhe bizneset deri tek ekonomitë rajonale. Me trendet e fundit të rritjes së aktiviteteve online, nëpër muze dhe institucione tjera kulturore, mundësia për komunikim me publik më të gjerë ka arritur pikën më të lartë në historinë e vet përmes digjitalizimit të praktikave të ruajtjes së trashëgimisë.

Trashëgimia e errët

Shumë nga shoqëritë bashkëkohore jetojnë me plagë të historisë që vijnë nga lufta, trazirat civile dhe nga dhuna sistematike shoqërore që nxisin armiqësi etnike dhe diskriminim racor.

Këto periudha të errëta në histori dhe trashëgimia që ato mbartin në shoqërinë e sotme, përfaqësohen përmes hapësirave të ndryshme, siç janë: vendet e masakrave apo varrezat masive, vendet që lidhen me të burgosurit e luftës dhe të burgosurit politik, memorialet dhe vendet përkujtimore. Këto janë vende që mund të sjellin dhimbje nga e kaluara për viktimat dhe turp për përdhunuesit për dhunën dhe ideologjitë që ata kanë përfaqësuar.

Prandaj, duke eksploruar nocionin e trashëgimisë së errët, ne synojmë të zgjerojmë interpretimin e hapësirave të caktuara që reprezentojnë të kaluarën e dhunshme dhe përvojat që shpalosim të kaluarën e errët, nga perspektiva bashkëkohore.

Arkivimi i së përkohshmes: Praktikët e dokumentimit në kohë reale

Arkivat janë sisteme të kujtesës kolektive. Gjithashtu, ato luajnë rol në formimin e kolektiviteteve kulturore të së ardhmes. Si ta akrivojme atë që është e përkohëshme apo kalimtare? Si do ta bartim dijen e realitetit pandemik tek gjeneratat e ardhshme? Arkivimi i së përkohshmes: Praktikët e dokumentimit në kohë reale hulumton projekte arkivore të cilat mund të jenë prodhuar në kontekst të përditshmërisë, që regjistrojnë tipare të përkohshme të mjedisit fizik, dhe kanë parasysh rrezikun e zhdukjes nga kujtesa kolektive.

Kjo fushë mund të përfshijë arkiva të reprezentuara në – dhe të mbledhura përmes – punëve kreative: praktika të vetë-dokumentimit, memoare, shkrime kreative jo-fiktive, ditarë vizuel, arte performuese, instalacione artistike, dhe arkiva hibride që ngërthejnë objekte materiale dhe gjithashtu adresojnë praktika që janë zhdukur për shkak të, dhe përtej pandemisë. Si përmbledhje, praktika të dokumentimit në kohë reale që krijojnë vlerë të shtuar dhe kontribuojnë drejtë asaj që mund të cilësohet si trashëgimi në të ardhmen.

Implementimi i projekteve të mbështetura

- Periudha e implementimit të projekteve të mbështetura do të fillojë më 1 tetor, 2020 dhe do të përfundojë më 28 shkurt, 2021.
- Të gjitha projektet duhet të jenë të gatshme për prezantim publik gjatë muajit mars 2021.
- Udhëheqësit e projektit do të duhet të raportojnë në baza mujore rreth progresit të projektit.
- Udhëheqësit e projektit do ta kryesojnë procesin e organizimit të prezantimit publik në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e Platformës Heritage Space.
- Përfituesit duhet të jenë të hapur për t'i diskutuar etapat e zhvillimit të projektit me mentorët e tyre.
- Përfituesi mund të bashkëpunojë me më shumë se një mentor.

Kufizimi i mundshëm: Platforma Heritage Space është e vetëdijshme për kufizimet e mundshme që mund të shfaqen për shkak të pandemisë aktuale globale. Implementimi i disa aktiviteteve mund të ndryshohet dhe/ose të shtyhet për më vonë. Në këtë mënyrë, ekipi ynë do të marrë parasysh çdo kufizim të mundshëm që mund të shfaqet në të ardhmen dhe do të përpiqet të përshtatet në mënyrën e duhur përmes marrëveshjes së ndërsjellë me përfituesit.

Çfarë do të ofrojë Heritage Space V?

Heritage Space do të:

- Ofrojë mentorim, konsultime dhe ekspertizë përmes katër mentorëve të përzgjedhur, të cilët do të ndihmojnë në zhvillimin dhe prezantimin e projekteve të përzgjedhura.
- Ndihmojë në krijimin e rrjetit të bashkëpunimit në mes të individëve dhe institucioneve të ndryshme kreative, që janë të domosdoshme për zhvillimin e suksesshëm të projekteve të përzgjedhura.
- Ofrojë mbështetje financiare për palët e angazhuara në projekt. Shuma mesatare e grantit është 5,000 euro, ndërsa shumat e grantit nuk e tejkalojnë vlerën prej 7.000 euro. Do të ofrohet financim shtesë për prezantimin publik të projekteve përfundimtare.
- Ofrojë mbështetje për të promovuar projektet e përzgjedhura gjatë gjithë zhvillimit dhe finalizimit të tyre.

Procesi i mentorimit

Për çdo edicion, platforma Heritage Space zgjedh katër mentorë të cilët ofrojnë ekspertizën e tyre për t'i mbështetur përfituesit përgjatë të gjitha fazave të zhvillimit dhe finalizimit të projektit. Mentori/ja është dikush që ofron këshillim, informacion dhe dije që buron nga përvoja, në adresimin e çështjeve dhe/apo mundësive që lindin përgjatë implementimit të secilit projekt.

Mentorët of Heritage Space V:

1. Veton Nurkollari **Drejtor artistik në “Dokufest”**
2. Erëmirë Krasniqi **Drejtoresh Ekzekutive në “Iniciativa e Historisë Gjoje”, Kosovë**
3. Nora Weller **Doktorante në Universitetin e Cambridge-it, departamenti i Arkeologjisë**
4. Leart Zogiani **Drejtuës i Kokrra and Skins Agency**

Klikoni [këtu](#) për më shumë informata rreth mentorëve të këtij edicioni.

Kush mund të aplikojë?

- Të gjithë banorët e Kosovës, përmbi moshën 21 vjeçare, pavarësisht përkatësisë së tyre gjinore, etnike apo tjetër.
- Individët, idetë e së cilëve bazohen në mundësitë që ofrohen nga industritë kreative dhe trashëgimia kulturore.
- Individët që kanë njohuri elementare rreth trashëgimisë kulturore dhe fushës kreative.
- Artistë vizuel, dizajnerë, filmbërës, shkrimtarë, hulumtues, përformues, kuratorë, antropologë, historianë, fotografë, zejtarë dhe çdokush tjetër, aktiviteti kreativ i të cilit/ës përkon me kriteret e aplikimit.
- Më së shumti dy (2) individë mund të aplikojnë me një ide - projekt.

**Ju rekomandojmë që të shpenzoni më shumë kohë përpara dërgimit të aplikacionit. Mos i kufizoni idetë e juaja vetëm në trashëgiminë e prekshme (ndërtesa apo objekte). Trashëgimia Kulturore përfshin edhe shumë aspekte tjera të jetës shoqërore.*

**Statusi i karrierës nuk është prioritet, meqenëse, ne besojmë se idetë mund të jenë të mrrrekullueshme pavarësisht përvojës profesionale apo akademike.*

**Aplikacionet pranohen në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe.*

Çfarë nuk mbështesim?

- Propozimet të cilat nuk kanë të bëjnë me industrinë kreative ose nuk ndërlidhen me trashëgiminë kulturore;
- Projektet e propozuara nga organizatat/kompanitë/OJQ-të;
- Idetë të cilat janë duke u implementuar tashmë nga ndonjë palë e tretë;
- Idetë që kanë të bëjnë me konzervimin e trashëgimisë së ndërtuar, adaptimin e ndërtesave dhe me gërmimet arkeologjike.

Cilat janë kriteret e vlerësimit?

Edicioni i këtij viti i Platformës “Heritage Space” do t’i favorizojë idetë që marrin parasysh tranzicionin e suksesshëm në sferën online, për të reaguar kështu ndaj kontekstit të ri social dhe kulturor si rezultat i pandemisë së vitit 2020. Preferojmë që të gjitha projektet të jenë në çdo kohë të qasshme online.

Komiteti i vlerësimit vepron sipas vizionit dhe vlerave të Heritage Space sa i përket diverzitetit, transparencës dhe gjithpërfshirjes. Komiteti do t’i vlerësojë aplikacionet në mënyrë të paanshme dhe konform vlerave të platformës Heritage Space.

Vlerësimi i aplikacioneve kryhet në bazë të informacionit të ofruar në dokumentet e dorëzuara duke marrë parasysh kriteret në vijim:

Cilësia: Cilësia e idesë, propozimi i metodës, materialeve dhe teknikave që do të aplikohen.

Kreativiteti: Vlera kreative dhe inovative e idesë së propozuar;

Përshatshmëria: Niveli në të cilin ideja përkon me objektivat e Heritage Space – mënyra përmes së cilës kjo ide trajton trashëgiminë kulturore, historinë, artin dhe kulturën;

Saktësia: Prezantim i qartë i aktivitetit / idesë;

Qëndrueshmëria: Ideja/propozimi do të “vazhdojë aktivitetet e saj/tij në mënyrë të pavarur” edhe pasi të jetë finalizuar, ndërsa rëndësia e tyre nuk kushtëzohet në afate kohore.

Buxheti: Përpilimi i mjeteve financiare të domosdoshme për idenë tuaj, arsyeshmëria e buxhetit;

Menaxhimi i kohës: Ideja duhet të finalizohet brenda pesë muajve, ndërsa përparësi kanë propozimet që më së miri planifikojnë mënyrën e organizimit të kohës së tyre;

Prezantimi / strategjia e komunikimit: Në ç’mënyrë planifikojnë aplikantët të prezantojnë ose komunikojnë produktin / rezultatet e tyre përfundimtare;

Njohuritë paraprake: Aplikanti duhet të zotërojë njohuri elementare mbi trashëgiminë kulturore dhe mediumin ose disiplinën ku do të punojë. Nevojitet më shumë njohuri në lidhje me temën specifike të zgjedhur për aplikim.

Menaxhimi i riskut: Aplikanti duhet të jetë i vetëdijshëm për pengesat e ndryshme të cilat mund ta rrezikojnë implementimin e suksesshëm të projektit të tyre (pengesat teknike, institucionale, burokratike, mundësia e qasjes etj);

Mundësia e qasjes: Puna/produkti final është i qasshëm për publikun në një periudhë afatgjate.

Në ç' mënyrë financohet Heritage Space?

Projekti Heritage Space implementohet nga CHwB Kosova. Aktiviteti i projektit financohet nga Qeveria Suedeze.

CHwB Kosova është pjesë e ILUCIDARE – një rrjet ndërkombëtar që do të ofrojë mbështetje dhe promovim për të gjithë përfituesit e mbështetur nga Platforma Heritage Space.

Afati i fundit për aplikim

Në mënyrë që aplikimi juaj të merret në konsideratë, nevojitet:

- Plotësimi i formularit për aplikim;
- Dërgimi i CV-së (portofoli, nëse është në dispozicion)
- Letërnjoftimi juaj (i skenuar)
- Aplikacionet mund të përmbajnë çfarëdo dokumenti shtesë që ka të bëjë me projektin, siç janë videot/audiot, konspektet, publikimet apo ndonjë dokument tjetër që mund të jetë i dobishëm në procesin e përzgjedhjes, për aq kohë sa ato shkëmbehen përmes vegëzës së internetit.

Ju lutemi ta plotësoni tërësisht këtë formular në kompjuter. Formulari për aplikim, së bashku me dokumentet e kërkuara duhet të dërgohen jo më vonë se: 05 shtator (në ora 23:59), në emailin: chwb.kosovo@gmail.com. Me rastin e dërgimit të aplikacionit përmes emailit, ju lutemi që tek subjekti i emailit të shkruani: "Aplikimi për Heritage Space 2020 (emri dhe mbiemri)".

Keni ndonjë pyetje?

Nëse ju nevojitet informata shtesë rreth Heritage Space dhe procesit të aplikimit, ju lutemi të merrni pjesë në seancën tonë informative online, e cila do të zhvillohet gjatë muajit gusht 2020. Për ta realizuar këtë, ju lutemi t'i ndiqni mediat tona sociale për informata. Përveç informatave të përgjithshme në lidhje me edicionin e pestë të Heritage Space, do të keni mundësinë të takoheni me mentorët dhe të konsultoheni me ta rreth çdo çështjeje që ka të bëjë me procesin e mentorimit.

Për çdo informacion shtesë, ju lutemi ta ndiqni faqen tonë në Facebook, CHwB Kosova, si dhe ta vizitoni faqen tonë të internetit www.chwb.org/kosovo, ose na kontaktoni në chwb.kosovo@gmail.com apo në numrin e telefonit +383 (0) 44665472 / +381 (0) 38 754 866, para datës 05 shtator, 2020.

Aplikacionet e suksesshme?

Aplikantët që e kalojnë fazën e parë të vlerësimit nga ana e jurisë, do të njoftohen përmes emailit dhe do të ftohet që t'i prezantojnë konceptet e tyre nëpërmjet intervistës para komisionit vlerësues, gjatë muajit shtator 2020. Aplikantët që vlerësohen si të suksesshëm në intervistë do të ftohen për ta finalizuar Planin e Veprimit dhe Buxhetin, pas të cilit do të nënshkruhet edhe kontrata.

